

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ I UROŠEVAC

NË EMËR TË POPULLIT

Më  
Dana:

11-08-2017  
GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Gjyqtari i vetëm gjykues Sahit Krasniqi

me sekretaren juridike Adelina Sallahu, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDAKTUAR], i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II. nr. 1211-6/16, të dt. 28 dhjetor 2016, për veprën penale “ rrezikim i trafikut publik ” nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor dënim me gjobë, në bazë të nenit 495 të KPP-së, me dt. 20.02.2017 mori këtë:

### AKT GJYKIM

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II. nr. 1211-6/16, të dt. 28 dhjetor 2016, dhe kjo gjykatë jepë këtë:

### URDHËR NDËSHKIMOR

Ndaj të pandehurit [REDAKTUAR] nga i ati [REDAKTUAR] dhe e ëma [REDAKTUAR] e vajzërisë [REDAKTUAR], i lindur më [REDAKTUAR] në Zvicër, me vendbanim në fshatin [REDAKTUAR] komuna e Ferizajt, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal [REDAKTUAR]

### ËSHTË FAJTOR

Se me datën 15.07.2016, rreth orës 21:00, në rrugën “Ahmet Shtimja” në Shtime, duke drejtuar motoçikletën e tipit “MBK YP 125 R”, ngjyrë e kaltër, pa targa të regjistrimit dhe pa regjistrim, në kundërshtim me nenin 54.1 të LSKRR-së, nga pakujdesia ka rrezikuar trafikun publik dhe jetën e njerëzve, në atë mënyrë që nuk ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes dhe kushteve të rrugës me kthesa, ashtu që humb kontrollin mbi drejtimin e motoçikletës, kalon në anën e majtë të rrugës dhe me pjesën e përparme e godet po ashtu në pjesën e përparme të dëmtuarin-biçiklistin [REDAKTUAR] i cili nga kjo goditje përplaset në tokë jashtë rrugës në anën e djathtë, me ç’rast pëson lëndime të lehta trupore dhe atë : plagë shqyese dhe ndrydhëse në hundë, vetullën e majtë dhe parakrahun e majtë, me pasoja të përkohshme për shëndetin, të përshkruara në ekspertizën mjeko ligjore të dt. 20.12.2016

**me të cilën ka kryer veprën penale “rrezikim i trafikut publik” nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së.**

Andaj konform nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 23, 41, 42, 43, 46, 73 të KPRK-së, dhe në bazë të nenit 495 të KPPK-së,

## **G J Y K O N**

**Me DËNIM NË GJOBË NË SHUMË PREJ 200 (DYQIND) €, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.**

Në rast se dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 të KPRK-së, i njëjti do ti shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1 (një) ditë burg.

I dëmtuari [REDAKTUAR] për realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Gjithashtu obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 60.88 €, dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, të gjitha në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II. nr. 1211-6/16, të dt. 28 dhjetor 2016, ka akuzuar të pandehurin [REDAKTUAR] për vepër penale “rrezikim i trafikut publik” nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrorit ndëshkimor me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj veprë penale nga i pandehuri.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrorit ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrorit ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 të KPP-së.

Gjykata me rastin e vlerësimit të provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës si: mendimet dhe konstatimet e eksperti të komunikacionit [REDAKTUAR] të dt. 26.11.2016, mendimit dhe konstatimit të ekspertit të mjekësisë ligjore Dr. [REDAKTUAR] të dt. 20.12.2016, raportit mjekësor të QKMF-së Shtime dhe QKUK-së Prishtinë të dt. 15.07.2016

si dhe fotografitë që gjenden në shkresat e lëndës, vërtetoi se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 463 par.2 të KPPK-së, Gjykata ka udhëzuar të dëmtuarin Rrahman Bislimi, që kërkesën pasurore – juridike mund ta realizon në kontest civil, meqë nga të dhënat e siguruara gjatë procedurës penale nuk japin të dhëna të plota e as të pjesërishtme për të vendosur lidhur me këtë kërkesë.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve është marrë në bazë të nenit 450 par.4 lidhur me par.2 nënpar 2.1 të KPPK-së, për shpenzimet e procedurës shumen prej 60.88 euro dhe për paushallin gjyqësor shumën prej 20 €.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**P. nr. 5/17 dt. 20.02.2017**


**Sekretare Juridike**

Adelina Sallahu



**Gjyqtari i vetëm gjykues**

**Sahit Krasniqi**



**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afatin prej 8 (tetë) ditësh, nga dita e pranimet të aktgjykimit, gjyqtarit individual të kësaj gjykate përmes kësaj gjykate. Pas kalimit të afatit për kundërshtim, urdhëri ndëshkimor merrë formën e prerë dhe dënimi i shqiptuar ekzekutohet.

